



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0602**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 21 dhe 29 të Rregullores së Punës 01/2020 e amendamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Albakos Safety" SH.P.K, kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe pajisje zjarrfikëse." me numër të prokurimit VU644-23-7665-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë, më 17/10/2023, mori këtë:

## Vendim

- Aprovohet**, ankesa e OE "Albakos Safety" SH.P.K, me nr. 2023/0602, e datës 21/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe pajisje zjarrfikëse.", me numër të prokurimit VU644-23-7665-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë.
- Obligohet, AK Komuna e Vushtrrisë që për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe pajisje zjarrfikëse.", me numër të prokurimit VU644-23-7665-1-2-1, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë si dhe të zgjasë afatin për ofertim.
- Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informojë me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në harmoni me paragrafët specifik të dispozitivit të këtij Vendimi;
- Në rast të mosrespektimit të këtij Vendimi, Paneli Shqyrtues ka të drejtë që të ndërmarrë masa sikurse parashihen ato në nenin 131 të Ligjit për Prokurim Publik të nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092;
- Me qenë se ankesa aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.07.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me mjete dhe pajisje zjarrfikëse” me nr. të prokurimit: "VU644-23-7665-1-2-1".

Me 10.08.2023, OE "Albkos Safety Sh.p.k" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 11.08.2023, AK ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues.

Operatori ekonomik "Albkos Safety Sh.p.k" i pakënaqur me Njoftimin për kontratë, me 21.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokoll 602/23.

*- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 08.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- AK të bej zgjatjen e afatit për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar për rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e

palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

#### *Pretendimet e Ankuesit “Albakos Safety”SHPK*

- *Pretendimi i pare (I)*- “OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 28 të LPP-së gjatë hartimit të specifikave teknike, për shkak se specifikat teknike i ka përshtatur për OE/ prodhues të caktuar.OE ankues thekson se me dt. 04.08.2023 kemi bere kërkesë për informata shtesë dhe brenda afatit kohor nuk kemi marrë përgjigje dhe kemi bërë kërkesë për rishqyrtim me dt. 10.08.2023, ku kërkesa jonë për rishqyrtim është aprovuar si pjesërisht e bazuar me arsyetimin se AK, specifikimet teknike për pajisje dhe mjetet në fjalë do ti korrigjoj dhe përshtat në harmoni me natyrën e AP. Ne nuk pajtohemi me vlerësimin e AK-së me arsyetimin e AK-së, sepse kërkesa për rishqyrtim nuk ka të bëjë me veprimet të cilat AK planifikon t’i ndërmarrë në të ardhmen.Me dt. 11.08.2023 AK ka publikuar njoftimin për korrigjimin e gabimeve dhe versionin e korrigjuar të DT-së. Megjithatë AK nuk ka dhënë sqarime as ndryshimet e nevojshme në mënyrë që specifikimet teknike të jenë në përputhje me nenin 28 të dhe Nenin 1 të LPP-së.Specifikimet teknike edhe më tutje janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP – së, sepse janë përshtatur për prodhues të caktuar, duke përjashtuar të gjitha mundësitë për një konkurrencë të barabartë dhe duke përcaktuar fituesin e tenderit, si dhe bëhet fjalë për produkte të prodhuesve Sthil, Victor Inox, Nightstic, Tipsa etj, përfaqësi të një operatori të caktuar ekonomik”.

#### *Konstatimet dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën 602/23*

- *Konstatimi i parë (I)*- Pas analizimit të dokumentacionit të lëndës të ofruar në E prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se me dt. 04.08.2023 OE ankues ka paraqitur kërkesë për informatë shtesë në lidhje me arsyetimin se specifikimet teknike janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së dhe favorizojnë prodhues të caktuar dhe OE. Ndërsa me dt. 10.08.2023 OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim, ku me dt. 11.08.2023 i është aprovuar kërkesa për rishqyrtim si pjesërisht e bazuar dhe në të njëjtën ditë është bërë edhe publikimi i dosjes së tenderit i ndryshuar, ku edhe më tutje OE ankues pretendon se specifikat teknike edhe më tutje janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së. OE ankues me theks të veçantë në ankesë ka paraqitur pretendime ankimore për pozicionin 6 dhe 8 të specifikacionit teknik, duke mos anashkaluar edhe pozicionet tjera në kuptim të përgjithshëm. Në pozicionin nr.6 “Bateri profesionale shumë funksionale- rimbushëse për zjarrfikës”, e kërkuar nga ana e AK-së, eksperti shqyrtues ka hulumtuar në internet dhe ka vërejtur se specifikat teknike të kërkuara nga AK për këtë pozicion, ngjasojnë me specifikat e produktit (baterisë) “XPP-54566RX” të prodhuesit “NIGHTSTICK”. Andaj eksperti shqyrtues vlerëson të qëndrueshëm pretendimin ankimor dhe se AK duhet t’i heq limitet të cilat favorizojnë ndonjë OE apo ndonjë prodhues të caktuar dhe të hap konkurrencën në mënyrë që të ketë më shumë OE pjesëmarrës dhe të veprojnë në plotni me paragrafët e nenit 28 të LPP-së. Në lidhje me pozicionin nr.8 të paramasës, ku OE ankues thekson se ky artikull është përshkruar edhe në një tender tjetër nga ana e AK-së për të cilin OSHP kishte konstatuar që është në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së. Eksperti shqyrtues, vlerëson se duke u bazuar ne aneksin 1, specifikime teknike të detyrueshme dhe ne pretendimin ankimore të OE ankues për Pozicioni nr.8 “Pompe shpinore, kapacitet 19 deri 20 Litër”, pas verifikimeve te bere ne internet, konkretisht në uebfaqen e prodhuesit “[https://ëëë.tipsa.com/product-category/genfo-backpacks/.](https://ëëë.tipsa.com/product-category/genfo-backpacks/)”, rezulton se specifikat

teknike të kërkuara nga AK-ja për pozicionin nr.8 ngjasojnë me specifikat teknike të një prodhuesi të caktuar “Genfo ” e qe është në kundërshtim me neni 28 dhe neni 7 si dhe me të gjitha dispozitat ligjore te LPP-se. Andaj, eksperti shqyrtues rekomandon që të aprovohet ankesa e OE, dhe AK-ja të mos vej limite të cilat favorizojnë ndonjë prodhues apo ndonjë OE, si dhe kërkesat për specifika teknike të mos i referohen ndonjë prodhuesi të caktuar, apo brendi të caktuar. Të veprohet në plotni me nenin 28 të LPP-së, dhe të zgjatet afati për ofertim”.

*- Konstatimet e panelit shqyrtues -*

Duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli.

Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertëve shqyrtues (profesional dhe teknik) janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim. Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kritere diskriminuese, PSH mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është se kërkesa e cekura në pretendimet ankimor të OE ankues, si të tilla paraqesin diskriminim, andaj PSH obliguon AK që të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të ekspertit shqyrtues, të bëra në raportin e ekspertizës. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

*- Përfundim -*

Paneli shqyrtues konsideron se një pjesë e pohimeve ankimore janë të bazuara, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, 27 dhe 28 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - ALBKOS SAFETY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: